



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Tiranë, më 13.9.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

Për projektligjin: “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri””.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në mbledhjen e datës 13 shtator 2018, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “ Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”

Projektligji është në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, dhe nenet 17 e 23, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo marrëveshje ka si bazë marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të datës 21 tetor 1988 për bashkëpunim teknik dhe marrëveshjen ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për punësimin e punëtorëve për zgjerimin e njohurive të tyre profesionale dhe gjuhësore, nënshkruar më 10.12.1991.

Gjithashtu, marrëveshja ka si bazë rezultatet e bisedimeve për bashkëpunimin për zhvillim, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë, më 12 korrik 2016.

Në komision, për të prezantuar projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e deputetëve, ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve dhe sqaruan pikat kryesore, objektivat, synimet dhe mënyrën e realizimit të kësaj marrëveshje.

Të ftuarit në komision theksuan, se, menaxhimi i migracionit është parashikuar si një prej prioritetëve kryesore të integritetit, dhe qëllimi i kësaj marrëveshje është forcimi i kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës dhe përmirësimin e kushteve kuadër për migracionin e ligjshëm në vendet e përzgjedhura partnere. Gjatë prezantimit të marrëveshjes i theksua se ky objektivi do të ndiqet në mënyrë aktive në këto fusha veprimtarie:

- Këshillimi për migracionin: lufta kundër migracionit të parregullt, nëpërmjet rritjes së mundësive të marrjes së informacionit për rrugët ligjore të migracionit për migrantët e mundshëm, me anë të këshillimit për migracionin; marrja e informacionit lidhur me perspektivat e arsimimit dhe të tregut të punës për migrantët e mundshëm dhe të kthyerit;

- Këshillimi për politikën e migracionit: përmirësimi i politikave për migracionin e ligjshëm dhe kontributet zhvillimore të migracionit, rritja e kapaciteteve institucionale, bashkëpunimit dhe dialogut.

Objektivat e sipërpërmendur janë pjesë e programit global, “Migracioni për zhvillim” (PME), të autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), të cilat, që prej 23 dhjetorit 2015 janë autorizuar të të zhvillohen edhe në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, objektivat e marrëveshjes janë në përputhje me masat e parashikuara në përparësinë strategjike A të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020.

Gjatë pyetjeve dhe diskutimeve në komision, deputetët kërkuar që të jepen shpjegime për mënyrën e zbatimit të kësaj marrëveshje, e cila do të shmangë migracionin e parregullt.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan se, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar lidhur me arsimin dhe formimin profesional e perspektivat e tregut të punës, si në Gjermani, ashtu edhe në Shqipëri do të bashkëpunohet në

- fushat e këshillimit për migracionin dhe, më konkretisht, në këshillimin dhe informimin e grupeve të caktuara mbi mundësitë e migracionit të ligjshëm të punës dhe perspektivat e arsimimit dhe të punësimit në Shqipëri;

- përditësimin dhe ofrimin e materialeve informative rreth migracionit të punës, mundësitë për hyrje në tregun gjerman të punës dhe trajnimet përkatëse për personelin e sporteleve të migracionit;

- ngritjen e kapaciteteve të sporteleve ekzistuese të migracionit të SHKP-së lidhur me informimin mbi rrugët ligjore të migracionit të punës;

- përmirësimin e bazës të të dhënave për aktorët në terren dhe situatën e grupeve të synuara si dhe krijimin e një rrjeti me aktorët përkatës në fushën e arsimimit dhe punësimit.

Pas përgjigjeve të marra nga të ftuarit, Komisioni e konsideron marrëveshjen mjaft të rëndësishme, pasi, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet të luftohet migracioni i parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar lidhur me arsimin dhe formimin profesional e perspektivat e tregut të punës, si në Gjermani, ashtu edhe në Shqipëri.

Pas diskutimeve të deputetëve për marrëveshjen në fjalë, Komisioni, vetëm me votat e përfaqësuesve të mazhorancës, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e saj në komisionin përgjegjës.

Përfaqësuesit e opozitës nuk morën pjesë në mbledhjen e komisionit.

**Zv. Kryetarja
Elisa SPIROPALI**